Funded by
the European Union

MODELI KOLEGIAL I SIGURIMIT TË CILËSISË NË KOSOVË

# RUBRIKA E VËZHGIMIT DHE FUSHAT E TRAJNIMIT

Projekti “Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë”

| | Performancë e shkëlqyeshme | Performancë e mirë | Performanca duhet të përmirësohet | Performanca e pakënaqshme | Fushat e trajnimit |
|---|---|---|---|---|---|
| **Planifikimi** | Objektivat e orës mësimore janë të qarta dhe të ndërlidhura me temën.<br>Plani e evidenton qartë të nxënit e individualizuar nëpërmjet përdorimit të aktiviteteve, diferencimit dhe strategjive të vlerësimit.<br>Burimet e propozuara përputhen qartë me objektivat e orës mësimore.<br>Nxënësit sfidohen në mënyrë të duhur. | Objektivat e orës mësimore janë të qarta dhe të ndërlidhura me temën.<br>Plani përpiqet ta individualizojë të nxënit nëpërmjet përdorimit të aktiviteteve, diferencimit dhe strategjive të vlerësimit.<br>Burimet e propozuara përputhen me objektivat e orës mësimore.<br>Disa detyra i sfidojnë nxënësit. | Objektivat e orës mësimore përmenden, por nuk janë të ndërlidhura me temën.<br>Plani mësimor e përshkruan orën e mësimit, por ka pak dëshmi për përpjekje që të individualizohet të nxënit nëpërmjet përdorimit të aktiviteteve, diferencimit dhe strategjive të vlerësimit. | Planifikimi dhe përgatitja janë të jo-adekuate, të paqarta ose mungojnë. | • Diferencimi sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor.<br>• Planifikimi i orëve efektive mësimore. |
| **Njohja e lëndës** | Njohuri të shkëlqyera për lëndën. Mësimdhënësi i përshtat njohuritë akademike me moshën dhe aftësitë e nxënësve. Mësimdhënësi e ndërlidh me mjeshtëri lëndën me situata praktike nga jeta reale. | Njohuri të zhvilluara mirë për lëndën. Mësimdhënësi zakonisht i përshtat njohuritë akademike me moshën dhe aftësitë e nxënësve. | Njohuri të sigurta të lëndës. Mësimdhënësi zakonisht i përshtat njohuritë akademike me moshën dhe aftësitë e nxënësve. Gabimet ndodhin por janë të rralla. | Njohuri të kufizuar të lëndës. Ose njohuritë mbi lëndën janë të papërshtatshme për moshën dhe aftësitë e nxënësve. Mësimdhënësi bën gabime të shpeshta lidhur me lëndën që ligjërohet. | Trajnim mbi njohjen e lëndës |
| **Sjellja dhe qëndrimi i nxënësve ndaj të nxënit** | Nivel shumë i lartë i angazhimit, mirësjelljes, pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit ndërmjet të gjithë nxënësve. Ekziston një klimë produktive për të mësuar, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të sigurt. | Shumica e nxënësve janë të respektueshëm dhe të sjellshëm. Ata përmbushin vazhdimisht pritjet e mësimdhënësit. Ekziston një klimë produktive për të mësuar. | Ekziston një klimë e përgjithshme pozitive për të mësuar, megjithëse niveli i angazhimit të nxënësve është mesatar. | Nuk ka asnjë dëshmi që tregon se ekziston një klimë pozitive për të mësuar. | • Diferencimi sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor.<br>• Të nxënit aktiv<br>• Të nxënit bashkëpunues<br>• Të nxënit me nxënësin në qendër<br>• Strategjitë e të nxënit të vetë-rregulluar |
| | Ora e mësimit vazhdon pa ndërprerje. Strategjitë e menaxhimit të sjelljes kontribuojnë në klimën e vazhdueshme pozitive për të mësuar. Qëndrimi i nxënësve ndaj të nxënit të tyre dhe qëndrimi i të tjerëve për të mësuar është shembullor. | Strategjitë e menaxhimit të sjelljes zbatohen vazhdimisht. Nxënësit reagojnë mirë ndaj sistemeve të sjelljes së mësimdhënësit dhe punojnë mirë së bashku. | Ndërprerja e madhe në mësim-nxënie është e pazakontë, por mund të ndodhin ndërprerje të nivelit të ulët. Nxënësit jo gjithmonë u përgjigjen menjëherë veprimeve të nxënësve. | Sjellja menaxhohet keq. Nxënësve u mungon angazhimi dhe ndërprerja e vazhdueshme e nivelit të ulët kontribuon në nivelin e ulët të të nxënit dhe në mjedisin e çrregullt në klasë. | Strategjitë e menaxhimit të sjelljes pozitive. |
| **Vlerësimi formativ dhe informatat kthyese** | Mësimi paraprak vlerësohet me saktësi nëpërmjet vlerësimeve diagnostifikuese, si p.sh. pyetjet me shumë zgjedhje dhe vlerësimet tjera formative me cikël të shkurtër.<br>Vlerësimet diagnostifikuese përdoren në mënyrë të duhur. Mësimdhënësi përgjigjet në mënyrë efektive ndaj vlerësimeve diagnostifikuese gjatë orës së mësimit dhe e përshtatë orën mësimore në përputhje me rrethanat. | Shkathtësitë dhe njohuritë paraprake vlerësohen dhe referohen nëpërmjet vlerësimeve diagnostifikuese gjatë orës së mësimit, si p.sh. pyetjet me shumë zgjedhje dhe vlerësimet tjera formative me cikël të shkurtër.<br>Mësimdhënësi përgjigjet deri në një masë në vlerësimet diagnostifikuese gjatë orës së mësimit dhe i bën disa përshtatje në mësimdhënie dhe të nxënit. | Edhe pse bëhen përpjekje për t'i vlerësuar njohuritë paraprake, vlerësimi nuk i vlerëson në mënyrë të saktë njohuritë paraprake të nxënësve. Ka disa dëshmi se mësimdhënësi e përshtat mësimdhënien dhe të nxënit gjatë orës mësimore duke u bazuar në në vlerësimin nga vëzhgimi i klasës. | Vlerësimi e merr pak parasysh mësimin paraprak. Nuk ka asnjë dëshmi të vlerësimit formativ diagnostifikues, si p.sh. pyetjet me shumë zgjedhje gjatë orës së mësimit. Mësimdhënësi nuk bën asnjë përshtatje në mësimdhënie dhe në mësim-nxënie. | Strategjitë e mësimdhënies ndërvepruese<br>(Vlerësimi formativ me cikël të shkurtër) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Vlerësimi formativ dhe informatat kthyese** | Nxënësit përgjigjen në informata kthyese të përshtatshme me shkrim ose me gojë. Ata e dinë se sa mirë kanë performuar dhe çfarë duhet të bëjnë për t'u përmirësuar. | Nxënësve u jepen informata kthyese me shkrim ose me gojë dhe ata përgjigjen kur inkurajimi është i qartë dhe specifik. | Nxënësve u jepen disa informata kthyese me gojë ose me shkrim, por kjo nuk është e mjaftueshme apo e mjaftë e qartë për ta përmirësuar të nxënit e tyre. | Nxënësit notohen me 1,2,3,4,5 pa informata kthyese me shkrim ose me gojë. | Informatat kthyese dhe notimi |
| | Nxënësit mund ta vetë-vlerësojnë punën e tyre në mënyrë të sigurt dhe punën e shokëve të klasës. Ata mund të përcaktojnë qëllime dhe objektiva për t'u përmirësuar. | Nxënësit e vetë-vlerësojnë rregullisht punën e tyre dhe punën e shokëve të klasës, sipas kritereve të qarta. | Nxënësit e vetëvlerësojnë punën e tyre ndonjëherë, kur kjo kërkohet nga mësimdhënësi i tyre. | Nxënësit nuk e vetëvlerësojnë asnjë punë të tyre. Nxënësit notohen me 1,2,3,4,5 pa informata kthyese. | • Informatat kthyese dhe notimi<br>• Të nxënit të vetë-rregulluar |
| **Strategjitë e mësimdhënies** | Orët mësimore përfshijnë strategjitë kreative që i sfidojnë nxënësit. Ata inkurajojnë të menduarit kritik dhe kreativitetin. Strategjitë e mësimdhënies individualizojnë të nxënit nëpërmjet diferencimit të përmbajtjes së procesit, produktit dhe mjedisit mësimor. | Ekzistojnë disa prova që nxënësit sfidohen dhe inkurajohen për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese, dhe detyrat janë të diferencuara për t'i përmbushur nevojat individuale me një kombinim të përmbajtjes së procesit, produktit dhe mjedisi mësimor, por kjo nuk bëhet vazhdimisht gjatë orës së mësimit. | Strategjive u mungon diferencimi, por mësimdhënësi arrin t'i plotësojë disa nevoja individuale dhe të ofrojë disa sfida shtesë. | Nuk ka dëshmi të objektivave të mësim-nxënies apo të diferencimit. Të gjithë nxënësit e kryejnë të njëjtën detyrë me të njëjtin ritëm. Aktivitetet nuk i plotësojnë nevojat individuale të nxënësve. | • Diferencimi sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor.<br>• Të nxënit aktiv<br>• Të nxënit bashkëpunues<br>• Të nxënit me nxënësin në qendër<br>• Strategjitë e të nxënit të vetë-rregulluar |
| | Bërja e pyetjeve në mënyrë sistematike e nxitë të kuptuarit, identifikon konceptet e gabuara dhe i parashikon intervenimet. Përgjigja e mësimdhënësit ndaj pyetjeve ka një ndikim të dukshëm në të nxënit e nxënësve. | Mësimdhënësi dëgjon dhe vëzhgon me kujdes. Pyetjet i trajtojnë me mjeshtëri disa koncepte të gabuara. | Puna monitorohet gjatë orës mësimore. Ka përdorim të kufizuar dhe jo-efektiv të pyetjeve të vlerësimit diagnostifikues/formativ. | Mësimdhënia karakterizohet nga pyetjet e mbyllura për disa nxënës. Pyetjet e vlerësimit diagnostifikues/formativ nuk përdoren. | Strategjitë e mësimdhënies ndërvepruese (Vlerësimi formativ me cikël të shkurtër)<br><br>Përdorimi efektiv i pyetjeve |
| | Mësimdhënësi e menaxhon orën mësimore në mënyrë të shkëlqyeshme. Mësimdhënësi e përdorë ritmin në mënyrë të duhur për t'i thelluar njohuritë e nxënësve në mënyrë të duhur dhe për t'i sfiduar ata. | Mësimdhënësi e menaxhon orën e mësimit në atë mënyrë që ritmi i detyrave të ndikojë pozitivisht në të nxënit, edhe pse sfida nuk është gjithmonë e pranishme. | Ritmi i orës mësimore është shumë i shpejtë ose i ngadaltë. Efektet pozitive në mësim-nxënie janë të dukshme herë pas here. | Orës mësimore i mungon ritmi dhe rezulton me angazhim të paktë të nxënësve. Nxënësit duket se e kryejnë të njëjtën detyrë me të njëjtin ritëm. | • Diferencimi sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor.<br>• Të nxënit aktiv<br>• Të nxënit bashkëpunues<br>• Të nxënit me nxënësin në qendër<br>• Strategjitë e të nxënit të vetë-rregulluar |
| **Progresi në mësim-nxënie** | Të gjithë nxënësit tregojnë nivele të larta entuziazmi dhe interesimit. Ata janë të sigurt dhe të angazhuar në orën mësimore.<br>Nxënësit udhëheqin mësim-nxënien dhe i kuptojnë hapat e ardhshëm në procesin e të mësuarit. | Shumica e nxënësve janë të entuziazmuar dhe të angazhuar në orën mësimore. Ata i kuptojnë hapat e ardhshëm në procesin e të mësuarit. | Shumica e nxënësve janë të motivuar për të marrë pjesë në procesin e të nxënit, por ata nuk ndërmarrin asnjë iniciativë. | Nxënësit janë pasivë. Mësimdhënia nuk arrin t'i angazhojë, entuziazmojë ose t'i motivojë nxënësit. | • Diferencimi sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor.<br>• Të nxënit aktiv<br>• Të nxënit bashkëpunues<br>• Të nxënit me nxënësin në qendër<br>• Strategjitë e të nxënit të vetë-rregulluar |

- **Kjo matricë i përdor nivelet për t'i ndihmuar vëzhguesit të japin informata kthyese konstruktive. Matrica nuk ka nevojë të përdoret për t'i vlerësuar mësimdhënësit pasi që notimi është subjektiv dhe 1 orë mësimi nuk mund ta përfaqësojë në mënyrë të drejtë një fazë të mësim-nxënies.**

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Projektit KosEd dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.